



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1096/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbresha Kusi kandidatë për asamble të kuvendit komunal nga subjekti politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), në Gjakovë, paraqitur kundër anëtareve të qendrave të vendotimeve në fshatin Bobaj komuna Gjakovë, për shkak të parregullsive dhe manipulimin e votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Arbresha Kusi kandidatë për kuvendin komunal në Gjakovë nga radhët e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Arbresha Kusi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila pretendon se është e pakënaqur dhe nuk është bërë shënimi i saktë i votave nga ana e komisionerëve të qendrave të vendotimit në fshatin Bobaj, e njehta po ashtu mendon se në fshatin Dujak të Gjakovës është bërë mos numrimi i saktë i votave në këtë fshat. Po ashtu është bërë mos numrimi dhe mos përshkrimi i votave të sakta nga ana e komisionerëve në formularët e FRK-së. Parashtruesja e ankesën e mbështet në dëshmit e votuesve (familjare) të saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesës Arbresha Kusi nga komuna e Gjakovës. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse ato që pretendon pala ankuese, andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 1096/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 ( njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.